**VENDIM**
**Nr. 87, datë 15.2.2006**

# PËR ADMINISTRIMIN DHE MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË RECETËS ME RIMBURSIM

*(Ndryshuar me VKM nr. 727, datë 30.10.2007)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 36 të ligjit nr. 7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Receta me rimbursim është dokumenti, kundrejt të cilit realizohet mbulimi i çmimeve të barnave nga skema e sigurimeve shëndetësore.

2. Plotësimi i recetës me rimbursim bëhet sipas udhëzimeve të Ministrit të Shëndetësisë dhe Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, ndërsa ekzekutimi i saj bëhet në farmacitë/agjencitë farmaceutike të rrjetit të hapur, që kanë kontratë me ISKSH-në.

3. Receta me rimbursim jepet për pacientët e siguruar, kundrejt një tarife prej 100 (njëqind) lekësh. Kjo tarifë paguhet nga pacienti në farmacinë/agjencitë farmaceutike të rrjetit të hapur, që kanë kontratë me ISKSH-në. Të ardhurat e realizuara kalojnë në llogari të ISKSH-së.

*Përjashtohen nga pagesa e kësaj tarife të siguruarit, që me ligj ose akt nënligjor të veçantë, përfitojnë mjekim me barna falas.*

4. Formati dhe përmbajtja e recetës me rimbursim, të plotë dhe të pjesshëm, përcaktohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor. ISKSH-ja merr përsipër prodhimin dhe shpërndarjen e tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**